



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 627/6 Prot.

Tiranë, më 28.05.2026

V E N D I M

Nr. 135, Datë 28.05.2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 85¹ Regj., datë 31.03.2026 e shtetasit L. F.², kundër Kompanisë “Atlantik” Sh.a., për shkak të “shtetësisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues, ndër të tjera, informon se: *Ju drejtohem me këtë ankim për shkak se i jemi drejtuar disa herë Kompanië së Sigurimeve Atlantik Sh.a si nëpërmjet shkresave kërkesave dhe disa takimeve me kërkesen e tyre dhe në bindjen time vetëm për shkak se pala e dëmtuar është shtetas i huaj, ma vështirëson komunikimin dhe dhënien e zgjidhjes përfundimtare duke demshpërblyer sipas ligjit, dëmin që i është shkaktuar drejtuesit të automjetit. Si pasojë e aksidentit automobilistik shkaktuar nga mjeti motorrik i markës Audi me targë AB 898 GF i siguruar me policë sigurimi T.P.L (për përgjegjësinë ndaj palëve të treta) me nr. Serie 240242710, lëshuar nën përgjegjësinë e kompaniës Atlantik Sh.a, me periudhë mbulimi përgjegjësie nga data 23.04.2024 deri me datë 22.04.2025.*

¹ Plotësuar me shkresën nr. 830 prot., datë 29.04.2026.

² Përfaqësuar në këtë ankesë nga Av. G. N., sipas Prokurës së Posaçme nr. 1223 rep., datë 20.02.2025.

Më datë 28.08.2024 rreth orës 13.40 minuta, shtetasi P. T., ka qenë duke qarkulluar me automjetin autoveturë të markës Audi me targë AB898GF, në rrugën interurbane dytësore Milot-Lezhë, me drejtim lëvizje për në Lezhë dhe ne vendin e quajtur, para objektit në pronësi të R. U., ka humbur kontrollin mbi mjetin e tij dhe është përplasur me një automjet autokamp të markës Giottiline, Pla7 me targë CZ 7M5 TT7K, i cili po lëvizte nga Lezha për në drejtim të Milotit dhe drejtohej nga shtetasi me kombësi çeke, L. F., i datëlindjes 06.04.1957.

-Në bazë të aktit të ekspertimit autoteknik, datë 28.08.2024 është konkluduar se: Shkeljet e kryera nga ana e drejtuesit të mjetit të markës “Audi”, me targë AB898GF, të përfshirë në këtë ngjarje aksidenale, shtetasit P. T., i cili gjatë lëvizjes me mjet humbet kontrollin e drejtimit të mjetit dhe nuk ruan pozicionin e mjetit në karregiatë, del në korsinë e krahut të kudërt, korsinë e krahut të majtë, i pret rrugën dhe goditet me mjetin autokamp i markës “Peugeot”, me targë CZ7MS7778, i drejtuar nga shtetasi çek L. F., pra shkeljet e konstatuara si shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe konkretisht shkeljet e ligjit nr.8378, datë 22.07.1998, të nenit 139, pika 1 e tij si dhe të nenit 141 pika 1 e tij, të Kodit Rrugor, themi se janë këto shkelje që kanë ndikuar direkt në ardhjen e kësaj pasoje ”.

Lidhur me faktin dhe hetimet e kryera në kuadër të këtij procedimi penal, me qëllim arritjen në një përfundim të drejtë, fillimisht, do të analizohen elementët e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, me këtë përmbajtje: “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e rëndë të një personi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen e një personi, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet. Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në njëzet vjet.”

Në bazë të aktit të ekspertimit auto-teknik të datës 14.09.2024 sa i përket aksidentit të datës 28.08.2024 të ekspertimit është konkluduar se “...shkelja kryesore dhe determinante e ndodhjes së këtij aksidenti është kryer nga ana e drejtuesit të mjetit të markës “Audi” me targë AB 898 GF, shtetasit P. T., dhe pikërisht shkelja e neneve 139/1 si dhe e nenit 141 pika 1 ligjit 8378 datë 22.07.1998 (i ndryshuar) të K.Rrugor. Aktet e tjera të ekspertimit mjeko-ligjor kanë provuar që dëmtimet e personave pasagjerë nuk kanë qenë të tilla që të kategorizohen si të rënda.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka kërkuar në Gjykatë “Pushimin e procedimit penal nr.856, të vitit 2024 për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal dhe Gjykata e Rrethit Gjyqsor Lezhë me vendimin nr. 53-2025-44 98) datë 15.01.2025 ka vendosur: Pranimin e kërkesës së Prokurorië pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Pushimin e çështjes penale me nr.98-1569, regjister themeltar, që i përket procedimit penal nr.856, të vitit 2024, për akuzën e kryerjes së veprës penale të “Shkelja e Rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/1 të Kodit Penal.

Masat që kërkohen të ndërmerren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: Kostatimin e diskriminimit, si dhe marrja e masave për vendosjen në vend të ligjshmërisë, duke përfshirë edhe dhënien e dëmshpërblimit përkatës për shtetasin, i cili ka ardhur për pushime dhe, si pasojë e veprimeve të paligjshme dhe zvarritjeve, edhe sot nuk i është trajtuar dosja, ndërsa mjeti i është kthyer vetëm në muajin dhjetor.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 85 Regj., datë 31.03.2026 të shtetasit L. F., u konstatua se ankesa, nga pikëpamja formale, nuk përmbushte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, lidhur me përmbajtjen minimale të nevojshme për inicimin e procedurës së shqyrtimit të saj.

Në këtë kuadër, me qëllim garantimin e të drejtës së palës për plotësimin e ankesës dhe zhvillimin e një procesi administrativ të rregullt, me shkresën nr. 627/2 prot., datë 16.04.2026 të Komisionerit iu kërkua ankuesit të paraqesë informacion dhe dokumentacion shtesë lidhur me çështjen, përfshirë të dhëna mbi aktin e ekspertimit të dëmit dhe mënyrën e dorëzimit të tij pranë shoqërisë “Atlantik” sh.a., sqarime mbi momentin dhe rrethanat e diskriminimit të pretenduar, prova që lidhin shtetësinë me trajtimin diskriminues, komunikimet me kompaninë e sigurimeve, informacion mbi ankesat pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare apo ndjekjen gjyqësore të çështjes, si dhe çdo dokument tjetër mbështetës.

Me shkresën nr. 830 prot., datë 29.04.2026, është administruar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi plotësimi i dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar në kuadër të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur kundër shoqërisë “Atlantik” sh.a., përmes së cilës janë depozituar sqarime dhe dokumente mbështetëse lidhur me pretendimin për trajtim diskriminues për shkak të shtetësisë.

Me shkresën nr. 627/3 prot., datë 04.05.2026, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, drejtuar Kompanisë së Sigurimeve “Atlantik” sh.a. dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, është kërkuar paraqitja e parashtrimeve me shkrim dhe informacionit përkatës lidhur me trajtimin e dosjes së dëmshpërblimit të shtetasit L. F., si dhe sqarime mbi pretendimet për trajtim diskriminues për shkak të shtetësisë.

Në vijim të këtij komunikim, me email e datës 16.05.2026, nga ana e përfaqësuesit ligjor të ankuesit është dërguar një deklaratë për heqje dorë, në të cilën shprehet se: “Në lidhje me ankimin tonë të datës 31.03.2026, regjistruar me nr. 85 regjistri, plotësuar me shkresën nr. 830, prot., datë 29.04.2026, dorëzuar pranë Komisionerit Kundër Diskriminimit si dhe pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me datë 29.04.2026 për aksidentin automobilistik të ndodhur më datë 28.08.2024, rreth orës 13:40, ku shtetasi P. T., duke qarkulluar me automjetin autoveturë të

markës Audi me targa AB989GF, në rrugën interurbane dytësore Milot-Lezhë, është përplasur me një automjet autokamp të markës Giottiline, me targa CZ M5 T7K, i cili drejtohej nga shtetasi me kombësi çeke L. F., i datëlindjes 06.04.1957, i përfaqësuar prej meje, ju informojmë sa vijon:

Shoqëria e sigurimeve “Atlantik” sh.a. ka rënë dakord me vlerën e propozuar nga shtetasi çek, duke përbushur në mënyrë të plotë kërkesat e tyre për dëmshpërblim.

Pas diskutimeve dhe negociatave të detajuara teknike të zhvilluara ndërmjet meje dhe përfaqësuesve të lartë të shoqërisë së sigurimeve, edhe ne si palë jemi të vetëdijshëm për specifikën dhe vështirësitë që ka paraqitur ky rast, për shkak të përfshirjes së një mjeti të paidentifikuar në pasqyrat e akteve të policisë dhe të prokurorisë, si dhe për faktin se mjeti i shtetasve që përfaqësoj është një mjet specifik, për të cilin nuk ekziston përfaqësi shitjeje apo servisi i specializuar në Republikën e Shqipërisë.

Në përcaktimin e kostove reale të kompensimit ka ndikuar gjithashtu fakti se vetëm në muajin dhjetor 2025 u bë i mundur transportimi i mjetit drejt Republikës Çeke. Kostot e transportit, si dhe shpenzime të tjera të lidhura me çregjistrimin e mjetit dhe procedurat përkatëse, janë evidentuar prej nesh deri në fazën përfundimtare të negociatave.

Duke qenë se është arritur një marrëveshje e kënaqshme dhe në interes të klientëve të mi, e formalizuar me Akt-Marrëveshje Ndërmjetësimi të datës 15.05.2026, deklarojmë se heqim dorë nga çdo pretendim aktual apo i ardhshëm në lidhje me këtë rast sigurimi.

Gjithashtu, dëshiroj të theksoj se disponoj edhe një email falënderues nga klientët e mi çekë, i cili na është dërguar më datë 14.05.2026 pas marrëveshjes paraprake, njëkohësisht mua dhe shoqërisë së sigurimeve “Atlantik” sh.a., në lidhje me mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së këtij rasti.

Aktualisht kemi lidhur marrëveshjen për pagesë, e cila u është njoftuar klientëve të mi dhe ata janë shumë të kënaqur. Në këto kushte, me kërkesën dhe pëlqimin e tyre, heqim dorë përfundimisht nga ankimi ynë i depozituar pranë institucionit Tuaj.”

Me shkresën nr. 365/1 prot., datë 14.05.2026, të shoqërisë “Atlantik” sh.a., administruar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me nr. 627/4 prot., datë 15.05.2026, është përcjellë i njëjti informacion, nëpërmjet të cilit shoqëria ka dhënë shpjegime lidhur me trajtimin e rastit dhe ka informuar mbi dakordësinë e arritur ndërmjet palëve për zgjidhjen e çështjes dhe kompensimin e dëmit.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 85 Regj., datë 31.03.2026 të shtetasit L. F.³, kundër Kompanisë “Atlantik” Sh.a., për shkak të “shtetësisë”, pa një vendim përfundimtar për çështjen, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

³ Përfaqësuar në këtë ankesë nga Av. G. N., sipas Prokurës së Posaçme nr. 1223 rep., datë 20.02.2025.